



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 54, date 19.07.2018

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z. GEGË LUSHI, GJIN LUSHI, ADMIR PRRONI, GEGË FUSHA, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 19.07.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Gegë Lushi** (5 anëtarë familje) në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Gjin Lushi** (5 anëtarë familje) në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.

3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Admir Prroni** (5 anëtarë familje) në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.



Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Gegë Fusha** (5 anëtarë familje) në vlerën prej **100,000 lekë (njëqind mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.



5. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime për individë).
6. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.
7. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,033,686 lekë (një milion e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 396,700 lekë (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen z. **Gegë Lushi**, në total **1,430,386 lekë (një milion e katërqind e tridhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë)**.
8. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,339,209 lekë (një milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 450,900 lekë (katërqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen z. **Gjin Lushi**, në total **1,790,109 lekë (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e nëntë)**.
9. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 538,554 lekë (pesëqind e e tridhjetë e tetëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 234,820 lekë (dyqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen z. **Admir Prroni**, në total **773,374 lekë (shatëqind e shtatëdhjetë e tre mije e treqind e shtatëdhjetë e katër)**.
10. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 305,619 lekë (treqind e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 237,620 lekë (dyqind e tridhjetë e shtatëmijë e gjashtëqind e njëzet) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen z. **Gegë Fusha**, në total **543,239 lekë (pesëqind e dyzet e tremijë e dyqind e tridhjetë e nëntë)**.

11. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akomodimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjen e z. Gegë Lushi, Gjin Lushi, Admir Prroni, Gegë Fusha, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
12. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 400.000 lekë.
13. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
14. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 19.07.2018

Shpallur në datën 20.07.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR




Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 946/1 prot

Shkodër, më 31.07.2018

LËNDA: Lidhur me vendimin Nr.54 datë 19.07.2018 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt. 2.10.2016 “Për Prefektin”, të ligjit Nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” neni 29, neni 54 germa dh, neni 55/3, neni 64/c, ligjit Nr.8756 dt. 26.03.2001 “Për emergjencat civile” i ndryshuar, ligjit Nr.9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr.109/2017 dt.30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, Udhëzimit Nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKM Nr.329 dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit të Ministrise se Brendeshme dhe Financave Nr.263 dt.24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vkb Shkodër Nr.85 dt.26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shkodër”, **shqyrtoi VKB Shkodër Nr.54 datë 19.07.2018 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e Z.Gegë Lushi, Z.Gjin Lushi, Z.Admir Prroni, Z.Gegë Fusha, banesat e të cilëve janë dëmtuar, nga zjarri”.**

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore për familjet e dëmtuara, ndërsa sipas dokumentacionit teknik ndërtimor të hartuar nga ju (preventivat ndërtimorë) të shtëpisë të banimit të *Z.Admir Prroni* fshati Oblike, NJAD Ana e Malit dhe *Z.Gege Fusha* fshati Grude e Re, NJAD Rrethina zëri “**Kepje suvatim i brendshëm**” keni vendosur çmimin prej 169 leke/m², (standart i ndryshëm i miratuar në VKB nr. Nr.51 dt 19.07.2018), për të cilin ju duhet të bëni korrigjimet¹ duke pasur si referencë edhe VKB Nr.51 dt.19.07.2018 zërit “prishje suvatim muri me pastrim/pa pastrim 73 leke/ m² ose 146 leke/ m², në respekt të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3 datw 18.12.2016.

Gjithashtu edhe zëri “Heqje pllaka ekzistuese” të dy familjet e sipërcituara nuk është pjesë e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3 Dt.18.12.2016.

Me respekt,

PREFEKTI

ÇESK MILLJA



¹ Referohuni Kodit të Procedurave Administrative